



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut

Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



Zyra për Komunikim me Publikun

DATE/A:	05.01.2026
PËR/ZA/TO:	z. Faton PECL, Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut
NG/OD/FROM:	znj. Sofije Rushiti- Peci, Zyrtare për Informim
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti vjetor i Punës së Zyres së Komunikim me Publikun vitin 2025



Gjatë vitit 2025, Zyra për Komunikim me Publikun ka vazhduar misionin e saj për të siguruar transparencë, komunikim efektiv dhe bashkëpunim të hapur me qytetarët, mediat dhe institucionet e tjera.

Synimi kryesor ka qenë përmirësimi i informimit publik dhe rritja e pjesëmarrjes qytetare në proceset komunale.

Përmes vegje zyrtare <https://mitrovicesejuent.rks-gov.net/> dhe rrjeteve sociale Zyra për Komunikim me Publikun ka bërë publikimin e aktiviteteve ditore të Komunës së Mitrovicës.

Në ueb faqen zyrtare të komunës janë publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtura, duke përfshirë këtu vendimet, rregulloret, raportet, njoftimet, konkurset, raportet e planet e drejtorive komunale dhe dokumente tjera në interes të qytetarëve të Komunës së Mitrovicës.

Zyra për Komunikim me Publikun ka mbajtur kontakte të rregullta me media, duke përcjell njoftime e lajme ditore për aktivitetet e zhvilluara në komunë, ftesa etj.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë publikuar edhe planet, strategjitë dhe dokumentet tjera të rëndësishme si; Plani për konsultime publike, takimet publike, dëgjimet buxhetore, njoftimet, konkurset, dokumentet e prokurimit, dokumentet e kuvendit etj.

Si rezultat i publikimit të dokumenteve në ueb faqen zyrtare, Komuna e Mitrovicës është vlerësuar me 100% transparencë buxhetore nga Instituti GAP, duke u renditur ndër komunat më transparente në vend në menaxhimin e financave publike. Ky vlerësim i lartë është një dëshmi konkrete e modelit të qeverisjes që ndjek Komuna e Mitrovicës, ku transparencja dhe llogaridhënia ndaj qytetarëve janë në qendër të çdo vendimi institucional.

Vlerësimi nga Instituti GAP bazohet në monitorimin e rregullt të komunave lidhur me publikimin e dokumenteve buxhetore, raportet financiare, si dhe përfshirjen aktive të qytetarëve në proceset vendimmarëse.

Të gjitha njoftimet janë publikuar me kohë siç janë; mbajtja e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komiteteve të tjera obligative dhe jo obligative. Janë publikuar edhe materialet përcjellëse të cilat janë planifikuar të diskutohen në këto mbledhje.

Plani i konsultimeve publike është publikuar në këtë vegëz:

<https://mitroviccejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/01/Plani-i-Dokumenteve-per-Konsultime-Takime-Publike-dhe-Degjime-Buxhetore-per-viitin-2025-pdf.pdf>

Orari i dëgjimeve buxhetore është publikuar në këtë vegëz:

<https://mitroviccejugut.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/>

Njoftimet për takimet publike janë publikuar në këtë vegëz:

<https://mitroviceejugut.rks-gov.net/njoftime-per-takime-publike/>

Aktet komunale janë publikuar edhe në platformën e konsultimeve publike në nivel të Qeverisë

së Republikës së Kosovës. <https://konsultimet.rks-gov.net/>

Në raportin e MAPL-së për vlerësimin e transparencës në Komunë, Mitrovica ka të përmbushur të indikatorët e transparencës.

<https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/10/Raporti-i-performances-komunale-2024.pdf>

Të gjitha vendimet e kryetarit janë publikuar në ueb faqe në kohë reale.

<https://mitroviceejugut.rks-gov.net/vendimet-e-kryetarit-2/>

Njoftimet për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe të Kuvendit publikohen në ueb faqe të Komunës.

<https://mitroviceejugut.rks-gov.net/dokumentet-e-kuvendit/?tax=>

Gjatë kësaj periudhe kanë kaluar për Konsultim Publik;

Konsultim Publik – Rregullorja per Transparencë dhe Plani i Veprimt per Transparencë në Komunën e Mitrovicës së Jugut si dhe Konsultimi Publik – Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

<https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Njoftimi-per-Konsultim-Publik-Rregullorja-per-Transparence-dhe-Plani-i-Veprimt-per-Transparence.pdf>

<https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Njoftim-K-AB-2026-2028-konsultim-publik.pdf>

Dy takime publike të kryetarit të komunës me qytetarë

Pas mbajtjes së konsultimeve publike, janë përgatitur edhe raportet (me komente) për ecurinë e konsultimit dhe hartimit të dokumenteve të përgatitura nga Komuna.

<https://mitroviccejugut.rks-gov.net/procesverbalet-raportet-nga-konsultimet-publike/>

Gjatë këtij viti janë mbajtur gjithsej 4 degjime buxhetore.

<https://mitroviccejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Otari-i-degjimeve-buxhetore-me-qytetare-per-planifikimin-e-buxhetit-per-vitet-2026-2028-1.pdf>

Po ashtu Zyra për Komunikim me Publikum ka bërë publikimin e të gjitha dokumenteve në ueb faqe zyrtare të komunës të parapara me dispozita ligjore, me ç'rast janë publikuar gjithsej 107 Komunikata, Njoftime, dhe Konkurse.

Komunikatat 2025

1. Telegram ngushëllimi nga Komuna e Mitrovicës
2. Përfaqësuesit komunal bëjnë homazhe dhe nderime për figurën e akademik Minir Dushi
3. Nënshkruhet Memorandumi i Bashkëpunimit për projektin “Dhoma për Promovim dhe Edukim Shëndetësor”

4. Mbahet mbledhja e radhës e Komitetit për Politikë dhe Financa
5. NJOFTIM- aplikimi për subvencione për përballimin e shpenzimeve shëndetësore
6. Komunikatë nga Drejtoria e Arsimit
7. NJOFTIM PËR PREMIERËN E KOMEDISË “PROVINCA”
8. Sportistja më e mirë e vitit 2024 në Mitrovicë shpallet Blerina Gashi nga klubi i xhudos “Trepça”
9. Për nder të 17 Shkurrit, Ditës së Pavarësisë së Kosovës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizon program artistik
10. KB “Trepça” fiton Kupën e Kosovës për herën e katër radhazi
11. Ftesë- Baleti Kombëtar i Kosovës sjell baletin “HOPE” në Mitrovicë për 17-vjetorin e Pavarësisë
12. Në Mitrovicë mbahet koncert festiv për nder të 17-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës
13. Ndërron jetë Bajram Qerkin, vepimtari i palodhshëm për personat e zhdukur gjatë luftës në Kosovë
14. PREMIERA E DRAMËS “MENAXHERIA E QELQËT” NGA TENNESSEE WILLIAMS
15. Un Women dhe FAO mbajnë trajnim për fuqizimin e grave në zonat rurale të Mitrovicës
16. Komiteti për Politikë dhe Financa mbajti mbledhjen e rregullt – seancën e 37-të
17. Përkujtohen Muhamet Gashi dhe Gazmend Balu në 26-vjetorin e rënies së tyre
18. Kuvendi komunal mban mbledhjen e radhës, seancën e 38-të
19. Kuvendi Komunal i Mitrovicës mban seancë solemne për Epopenë e UÇK-së
20. Me nderime të larta për dëshmorët shënohet 27-vjetori i Epopesë së UÇK-së
21. Kryetari Hamza uron Diën e Mësuesit
22. Blerina Gashi fiton medaljen e bronzë në Kupën Europiane për Kadet në Antalya
23. Fillon faza e parë e Olimpiadës së Gjuhës Shqipe në Shkollat e Mesme të Ulët
24. Nënshkruhet marrëveshja për ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza Mitrovicë – Vushtri
25. Mbahet mbledhja e radhës e KKSB
26. Faza e dytë e testit në kuadër të Olimpiadës së Gjuhës Shqipe mbledh rreth 200 nxënës
27. F T E S Ë- komedia “Kontesha Arduini”
28. Mbahet mbledhja e 38 e Komitetit për Politikë dhe Financa
29. Urimi i kryetarit të komunës, Bedri Hamza, me rasin e Fitër Bajramit
30. Teatri i qytetit “Muhamet Qena” gjatë muajit prill do të rikthehet në skenë me një seri shfaqesh dhe reprizash që do të magjepsin publikun
31. Përkujtohet masakra në rrugën e Kovaçevës në Mitrovicë

32. Kryetari Hamza priti në takim Shëfen e Këshillit të Evropës në Kosovë, znj. Mary Ann Hennessey
33. Kryetari Hamza takoi ushtuesen e detyrës së Ambasadores së SHBA-së në Kosovë, znj. Anu Pratiipati
34. Mitrovica shënon Ditën e Tokës me mbjelljen e 50 pemëve përgjatë lumit Ibër
35. Donacion nga RAD Center me material shëndetësor për Ambulanten në lagjen “Adem Voca”
36. U mbajt mbledhja e 40-të e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa në Mitrovicë
37. NESËR NË MITROVICË SHËNOHET 26-VJETORI I RËNIES SË SHEMSI AHMETIT – KOMANDANT “SHEMT” DHE BASHKËLUTËTARËVE

38. Përkujtohet Epopeja e Melenicës dhe heroi kombëtar Shemsi Ahmeti në 26-vjetorin e rënies
39. Mbahet seanca e 39-të e Kuvendit të Komunës
40. Kryetari Hamza dhe nënkryetari Tahiri vizitojnë vendin e shpërtimit në Bair
41. Në fshatin Kçiq u zbulua pllaka përkujtimore për 19 martirët
42. U përkujtuan dëshmorët e fshatit Mazhiq
43. Përkujtohet dëshmori Artim Jashari
44. Kuizi i Diturisë “Mitrovica 2025” – Garë e dijeve dhe njohurive ekonomike
45. Drejtori Maxhuni pret përfaqësues të kompanisë Practal – në fokus siguria e vizitorëve në Parkun e Erës
46. Në Mitrovicë u shënuua Dita Botërore e Melanomës
47. Shënohet Dita Botërore e Hipertensionit
48. Kryetari Hamza pret në takim ambasadorin britanik Jonathan Hargreaves
49. Trepça, Kampione e Kosovës në Basketboll
50. Kryetari Hamza pret në takim kampionët e klubit “Trepça”
51. U përkujtua dëshmori Mehdi Hajredini në Mitrovicë
52. Nis puna në QKMF-në e re në Mitrovicë – kujdes shëndetësor 24 orë për qytetarët
53. U bë zbulimi i pllakës përkujtimore për dëshmorin Zeqir(Rexhep)Rexhepi
54. Komiteti për Politikë dhe Financa mban mbledhjen e 41-të të rregullt
55. Kryetari Hamza uron Kurban Bajramin
56. Në Mitrovicë shënohet 6 Qershori – Dita e Dëshmorëve
57. U mbajt Festivali i Teknologjisë – Tech Fest 2025
58. Mbahet ceremonia e diplomimit të maturantëve në Gjimnazin “Frang Bardhi”
59. U mbajt mbledhja e 42-të e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa

60. Kuvendi Komunal mbajti Seancën e 40-të të regullt
61. Përruhet objekti i ri i bibliotekës së gytetit "Latif Berisha" në Mitrovicë
62. DËGJIMET BUXHETORE ME QYTETARËT
63. FTESË- Për Dëgjimin e Parë Buxhetor me Kryetarët e Këshillave të Fshatrave
64. Ftesë për Dëgjimin e Dytë Publik për Buxhetin e vitit 2026 me Shogërinë Civile dhe Komunitetin Artistik
65. Mbahet dëgjimi i parë buxhetor për planifikimin e buxhetit të vitit 2026
66. Përruhet reparti i vaksinimit në objektin e ri të QKMF-së "Dr. Nexhat Çuni"
67. Ftesë për Dëgjimin e Tretë Buxhetor me Gratë dhe Vajzat
68. U mbajt dëgjimi i dytë buxhetor me Shogërinë Civile dhe Komunitetin Artistik
69. U mbajt dëgjimi i tretë buxhetor me gratë dhe vajzat e Mitrovicës
70. Ftesë- Dëgjimin e Katërt Buxhetor me Komunitetin Jo Shumicë
71. U mbajt mbledhja e radhës e KKS-së në Mitrovicë
72. Nënshkruhen kontratat me 300 studentë përfitues të bursave komunale
73. Mbahet dëgjimi i fundit buxhetor për planifikimin e buxhetit të vitit 2026
74. Mitrovica feston "Ditët e Diasporës"
75. Mitrovica me 100% transparencë buxhetore, sipas Institutit GAP
76. Nënshkruhet memorandum bashkëpunimi në mes të Komunës së Mitrovicës dhe "Qatar Charity"
77. Aktivitete në kuadër të Javës Botërore të Ushqyerjes me Qumësht Gjiri 2025
78. Përkujtohet veprimtari i shquar i çështjes kombëtare Sabit Veseli
79. Nis festivali "Mitrovica International Jazz Days" me një hapje madhështore
80. Komuna e Mitrovicës e gatshme për fillimin e vitit shkollor 2025/26
81. Mbahet mbledhja e 44-të e jashtëzakonshme e KP-së
82. "Minas Music Festival" nderon përfaqësuesit e kulturës nga Mitrovica
83. U mbajt mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa
84. Kuvendi Komunal i Mitrovicës miraton Buxhetin për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027 dhe 2028
85. Përkujtohen dëshmorët Agim Ramadani dhe Mustaf Shyti në 27-vjetorin e rënies
86. Kryetari Hamza priti në takim ish-Presidentin e Shqipërisë, Alfred Moisiu
87. NJOFTIM PËR VAKSINIMIN KUNDËR GRIPIT SEZONAL
88. Përruhet çerdhja e re në lagjen Shipol

89. Autoambulancë e re për QKMF-në në Mitrovicë
90. Betohet kryetari i ri i Komunës së Mitrovicës z.Faton Peci
91. Kryetari z. Faton Peci nderon heronjtë dhe dëshmorët e kombit
92. Kryetari Faton Peci priti në takim Presidenten Vjosa Osmani
93. Kryetari Faton Peci dhe Presidentja Vjosa Osmani vizitojnë çerdhen publike “Gëzimi Ynë”
94. Kryetari Faton Peci themelon Komisionin për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore
95. Themelohet Ekipi Mjekësor Geriatrik për kujdesin ndaj të moshuarve
96. Inaugurohet ura e re për këmbësorë mbi lumin Ibër – Kryeministri Kurti viziton Komunën e Mitrovicës
97. Kryetari Faton Peci meir vendim për ofrimin e shërbimeve komunale gjatë vikendit
98. Kryetari Faton Peci priti në takim Ministren e Arsimit, Arbërie Nagavci
99. Hapet zyrtarisht “Sheshi Festiv” në Mitrovicë
100. Kryetari Faton Peci priti në takim ambasadorin e Britanisë Hargreaves
101. Reagim i menjëhershëm në Selac – Kryetari Faton Peci në terren
102. Kryetari Faton Peci viziton punimet në rrugën Vllahi–Zhazhë–Mitrovicë
103. Njoftim- Lidhur me ditët e pushimit për festat zyrtare
104. Atmosferë festive në qytet – performime muzikore çdo natë

105. Kryetari Faton Peci priti në takim përfaqësuesen e Kosovës në RYCO
106. Kryetari Faton Peci e nisi ditën me punëtorët e pastirimit
107. Mbrëmje festive në sheshin "Isa Boleini"

Gjatë kësaj periudhe dymbëdhjetë muajore Janar- Dhjetor 2025, Zyra për Komunikim me Publikun, ka pranuar gjithsej 36 kërkesa për qasje në dokumente publike, ku 25 prej tyre janë parashtruar në formë elektronike dhe 11 në formë fizike.

Të gjitha kërkesat e parashtruara për Komunën e Mitrovicës kanë marrë përgjigje brenda afatit të paraparë ligjor, ku 20 prej tyre kanë marrë qasje të plotë, 11 qasje të pjesshme, ndërsa 3 janë refuzuar, 1 është hedhur poshtë dhe 1 është anuluar.

Të dhënat në formë të detajuar për secilën kërkesë për këta tre muaj mund ti gjeni në tabelat e mëposhtme.

Parashtruesi i	Mënyra e parashtrimit të kërkesës	Data e dërgimit tek drejtorja / zyrtari përkatës për vlerësimin	E vlerësuar	Numri i dokumenteve të kërkuara

				n e gasjes			
1.	Hana Zeka, SOWI KOSOVO L.L.C 01-030-04- 0004145-25	Fizike	23.01.202 5	27.01.20 25	Qasje e Pjesshme	29.01.20 25	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike që kanë të bëjnë me; Lejet e ndërtimit që janë dhënë nga komuna brenda 5 viteve të fundit për ndërtimet me destinacion banimi në Bajgorë; Kërkesat për lejet e ndërtimit të cilat janë ende në proces të shqyrtimit nga ana e komunës për ndërtimet me destinacion banimi në Bajgorë; Aplikimet për legalizim të ndërtimeve pa leje në zonën e Bajgorës 5 vitet e fundit dhe nëse eventualisht është marrë një Vendim nga Komuna, një kopje të tij.
2.	Leorenta Alija, OIQ “Democracy Plus” 01-034/01- 0007746/25	Elektronik e	06.02.202 5	07.01.20 25	Qasje e Pjesshme	11.02.20 25	Pala ka kërkuar qasje në informata zyrtare lidhur me kontratën e prokurimit “Ndërtimi i gerdhes për fëmiqë në Mitrovicë” me numër të prokurimit 642-24-7213-5-1-1.
3.	Mundësia Mitrovicë, OIQ “Mundësia NGO”	Elektronik e	11.03.202 5	11.03.20 25	Qasje e Plotë	18.03.20 25	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike lidhur me kontratën e prokurimit Nr. 642-24-7852-1-2-1 me numër të brendshëm 642-24-040-1-2-1, me titull “Furnizimi me tabela vetëdijesuese shporta për sheshe dhe trotuare”.

4.	Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale	Elektronik e	13.03.2022	13.03.2022	Qasje e Plotë	19.03.2022	Pala ka kërkuar qasje në informacione lidhur me konsultimet publike për vitin 2024.
	01-034/01- 0015954/25						
5.	Albana Rukolli, hulumtuese në Institutin GAP	Elektronik e	13.03.2022	14.03.2022	Qasje e Plotë	02.04.2022	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike/informata se a ka projekte Komuna e Mitrovicës së Jugut të cilat janë ndikuar nga masat e Bashkimit Evropian për Kosovën, nëse ka të ofroj informacion mbi; Emrin e projektit/masës/iniciativës; Instrumentin përkatës të financimit; shumën totale të planifikuar për projekt nga BE-ja; shumën totale të pezulluar nga BE-ja. Kërkesa në fjalë është trajtuar me afat shtesë prej 15 ditësh sipas Ligjit Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike.
	01-034/01- 0016015/25						
6.	OJQ “Mundësia NGO”	Elektronik e	11.03.2022	14.03.2022	Qasje e Plotë	20.03.2022	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike lidhur me përmbushjen e premtimeve të gjelbra nga programi zgjedhor i kryetarit të komunës.
	01-034/01- 0015894/25						
7.	Avokat Kadri Osaj,	Fizike	17.03.2022	18.03.2022	Qasje e Pjeshme	25.03.2022	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike për klientin që përfaqëson candidate në konkursin e datës 21.01.2025, për lëndën e Edukatës Muzikore në Sh.F.M.U “Aziz Sylejmani” në Mitrovicë.
	01-034/01- 0016339/25						

8.	Sheribane Selmani 01-034/01-0016642/25	Elektronik e	17.03.202	18.03.20	Qasje e Plotë	25	Pala ka kërkuar qasje në dokumentet publike dhe informata lidhur me masat e politikat komunale për sigurimin e përshatjeve të arsyeshme për nxënësit me nevoja të veçanta dhe atë lidhur me Politikat dhe Rregulloret nga Komuna; Buxhej dhe Financimi; Zbatimi dhe Monitorimi, si dhe Mbështetja për Mësuesit dhe Nxënësit.
9.	Bardhec Zymeri 01-034/01-0017916/25	Fizike	26.03.202	27.03.20	Qasje e Plotë	11.04.20	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike lidhur me Vendiimin e Kuvendit të Komunës Nr. 450/01 dt. 2203.2003 për caktimin e lokacionit të varrezave; projektin ideor të varrezave hartuar nga "Lin Projekt", miratuar nga Kuvendi i Komunës i dt. 22.03.2003; Caktimin e lokacionit të varrezave katolike sipas Planit të varrezave në Shqipëri dhe Mundësimi i qasjes të lokacioni i varrezave katolike.
10	Anisa Zogaj, hulumtuese në Institutin GAP 01-034/01-0022366/25	Elektronik e	15.04.202	17.04.20	Qasje e Pjesëme	16.05.20	Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare që lidhen me bizneset përfunduese të granteve dhe subvencioneve nga Komuna e Mitrovicës së Jugut për periudhën kohore 2018 deri në 2024
11	Halil Zeqiri, Drejtor në N.T.P "Labinoti" 01-034/01-0023524/25	Elektronik e	23.04.202	23.04.20	Qasje e Plotë	25.04.20	Kërkesa në fjalë është trajtuar me afat shtesë prej 15 ditësh sipas Ligjit Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike.
							Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike në dosjen e tenderit sipas Kontratës Publike me Nr. të dosjes B05-0007216 dhe Nr. të Prokurimit; 642-25-2661-2-2-1.

12	Gazeta “Prishtina Sot” e 01-034/01- 0023904/25	Elektronik e 5	24.04.202	24.04.20	Qasje e Plotë e 25	30.04.20	Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare që lidhen me marrëdhëniet ndërmjet Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Portali “Veriu.info” për periudhën kohore nga 1 Janar 2019 deri më sot.
13	Gazeta “Prishtina Sot” e 01-034/01- 0028434/25	Elektronik e 5	25.04.202	25.04.20	Qasje e Pjesshme e 25	15.05.20	Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare që lidhen me aktivitetet ndërtimore të kompanisë “Troy Residence” në territorin e Komunës së Mitrovicës, konkretisht kopje të të gjitha lejeve ndërtimore të lëshuara për “Troy Residence nga viti 2016 e deri më sot dhe “Ari Company”.
14	Gazeta “Rajoni” e 01-034/01- 0030848/25	Elektronik e 5	22.05.202	23.05.20	Qasje e Plotë e 25	27.05.20	Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare që lidhen me lëndën e Prokurimit me numër: 642-24-12027-2-1-1, konkretisht emrat e Komisionit Hartues të Specifikacioneve.
15	N.SH “Ambienti.G” e 01-034/01- 0031383/25	Fizike e 5	30.05.202	30.05.20	Qasje e Pjesshme e 25	02.06.20	Pala ka kërkuar qasje lidhur me aktivitetin e prokurimit me nr. 642-25-2807-2-2-2-1; Mirëmbajtja, ngrija dhe Revitalizimi i sipërfaqeve të gjelbëruara në qytet.
16	Izet Maxhera, Mitrovicë e Veriut e 01-034/01- 0032071/25	Fizike e 5	03.06.202	03.06.20	Qasje e Pjesshme e 25	09.06.20	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike në lidhje me Vendimin për leje ndërtimore të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm për parcelën kadastrale Nr. 2681-9 në Zonën Kadastrale Mitrovicë.

17	Florinda Kelmendi, Gazetare në “Kallxo.com”	Elektronik e	30.05.202	30.05.20	Qasje e Plotë	03.06.20	Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare që kanë të bëjnë me konkursin e shpallur për pozitën e Drejtorit të Bibliotekës “Latif Berisha” në Mitrovicë.
	01-034/01-0032247/25						
18	Izet Maxhera, Mitrovicë e Veriut	Elektronik e	03.06.202	03.06.20	Qasje e Pjeshme	09.06.20	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike lidhur me parcelën me numër 3861-0, dokumentet të cilat janë lëshuar nga Mitrovica e Jugut.
	01-034/01-0032072/25						
19	Kallxo.com	Elektronik e	20.06.202	20.06.20	Qasje e Plotë	23.06.20	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike në; Anulimin e konkursit për pozitën e drejtorit të Bibliotekës “Latif Berisha”.
			5	25		25	
20	Shkumbin Haxhiu, Mitrovicë	Fizike	30.06.202	30.06.20	Qasje e Plotë	04.07.20	Pala ka kërkuar qasje në Vendimin e lejes ndërtimore, sipas kërkesës së Valdett Fejzullahu B.L, emër tregtar N.N.T “Aurora”, ku është e përfshirë edhe parcela kadastrale P-71208072-03697-2
	01-034/01-0037895/25						
21	Altinë Spanca,	Elektronik e	12.06.202	12.06.20	Qasje e Pjeshme	01.07.20	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike që kanë të bëjnë me konkursin me numër reference 01-111/01-0014711-2/25 të datës 21.03.2025 për pranim të 8 (tetë) doktorëve të Mjekësisë.
	01-034/01-0038057/25		5	25		25	

22	Jehona Zhuniqi, "Smart ITS L.C.C"	Elektronik e	07.07.202	08.07.20	Refuzohet	09.07.20	Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare që kanë të bëjnë me Listën e Bizneseve të Regjistruara në Komunën e Mitrovicës së Jugut, duke kërkuar emrin e bizneseve, e-mail-in, numrin e kontaktues dhe adresën.
	01-034/01-0039772/25						
23	Fitore Parduzi, Kontabiliste e Certifikuar, Ekspert Gjyqësor Financiar	Fizike	10.07.202	10.07.20	Qasje e Plotë	11.07.20	Pala ka kërkuar qasje në informatat që kanë të bëjnë me kompensimin e pagave për vendin e punës, ndihmëse shtëpiake dhe atë se si kanë ndryshuar koeficientet për periudhën kohore nga viti 2017 deri në vitin 2025.
	01-034/01-0040534/25						
24	Rinor Arifi, Avokat nga Prishtina	Elektronik e	21.07.202	21.07.20	Refuzohet	25.07.20	Pala ka kërkuar qasje në dokumentet zyrtare që kanë të bëjnë me disa parcela që gjenden në Zonën Kadastrale Koritë-Komuna e Zveçanit, për të njëjtat duke kërkuar informata se a ka të regjistruar masë të sigurimit për këto parcela.
	01-034/01-0042666/25						
25	Erza Hyseini, Studente	Elektronik e	22.07.202	22.07.20	Qasje e Plotë	31.07.20	Pala ka kërkuar qasje në informata lidhur me faktorët strukturorë dhe mikro-social që ndikojnë në sjelljet devijuese të të miturve në qytetit tonë, duke kërkuar numrin e këtyre rasteve tek të miturit,

01-034/01-0043058/25					karakteristikat e rasteve, trendët ndër vite apo dokumente përkatëse për periudhën 2019-2024.		
26	Liridon Salihu Përfaqësues i Grupit për Studime Juridike dhe Politike 01-034/01-0043238/25	Elektronik e	21.07.2022	23.07.2025	Qasje e Plotë	24.07.2025	Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare/ informata që kanë të bëjnë me një grua nga Mitrovica, e cila sipas raportimeve si shkak i gjendjes shëndetësore dhe mungesës së përkujdesjes qëndron dhe flet pranë hyrjes së zyrës së Qendrës për Pajisje me dokumente në objektin e Komunës së Mitrovicës së Jugut.
27	Selviye Kurti, Menaxhere Projekti në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI) 01-034/01-0054532/25	Elektronik e	02.09.2022	03.09.2025	Qasje e Pjeshme	22.09.2025	Pala ka kërkuar qasje në informacion dhe dokumente zyrtare që lidhen me ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura në 3 komunat; Mitrovicë, Prishtinë dhe Podujevë.
28	Naser Berisha 01-034/01-0056761/25	Fizike	12.09.2022		Hedhur Poshtë		Pala ka kërkuar qasje në tjetërsimin e pronës së AKP-së tek pala e tretë. Megjenëse kërkesa e parashtruar ka qenë e paqartë, duke mos specifikuar dokumentet të cilat ka kërkuar qasje, pala ka përsëritur kërkesën e tij.

29	Kastriot Feka, Avokat nga Prishtina 01-034/01- 0058002/25	Fizike	18.09.202	19.09.20	Qasje e Plotë	24.09.20	Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare konkretisht kopjen e lejes së ndërtimit që i është dhënë kompanisë “Arjeta Group Sh.P.K” për ndërtimin e pjesës shtesë jashtë hapësirës së lokalit të marrë me qira në Stacionin e Autobusëve në Mitrovicë.
30	Naser Berisha 01-034/01- 0058497/25	Fizike	22.09.202	24.09.20	Refuzohet	26.09.20	Pala ka kërkuar qasje në dokumente dhe informata zyrtare që kanë të bëjnë me Zyrën Regjionale të AKP-së në Mitrovicë, andaj e njëjta meqenëse nuk është adresuar në Institucionin ku gjenden të dhënat është refuzuar.
31	Portali “Kosova News” 01-034/01- 0059057/25	Elektronik e	23.09.202	24.09.20	Qasje e Plotë	02.10.20	Pala ka kërkuar qasje në informata dhe dokumente zyrtare që lidhen me vizitën e Nënkretarit të Komunës në Uashington- Amerikë, në muajin Nëntor 2023 dhe Tetor 2024.
32	Hidavere Dajqi, 08-034/01- 0062436/25	Fizike	08.10.202	09.10.20	Qasje e Plotë	29.10.20	Kërkesa në fjalë është trajtuar me afat shtesë prej 15 ditësh sipas Ligjit Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike.
33	Rrona Zhuri, Kordinatorë e hulumtimeve në Institutin Gap	Elektronik e	14.10.202	14.10.20	Qasje e Plotë	16.10.20	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike dhe atë: Listën e shtëpive për të moshuar (publike dhe private) dhe shtëpive të komunitetit në Komunën e Mitrovicës sipas lokaliteteve, adresave dhe numrit të të moshuarve; Lista e qendrave ditore për të moshuar sipas lokaliteteve, adresave dhe numrit të të moshuarve.

	01-034/01-0063969/25					
34	Valbone Sadiku, Drejtoreshë Ekzekutive-CECD Friends 01-034/01-0063992/25	Elektronik e	14.10.2025	15.10.2025	Qasje e Pjesshme	20.10.2025 Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare lidhur me kontratën e prokurimit “Ndërtimi i Rrugëve Koprivë”.
35	Arben Rrahmani, Avokat nga Prishtina 01-034/01-0065439/25	Elektronik e	22.10.2025	22.10.2025	Qasje e Plotë	28.10.2025 Pala ka kërkuar qasje në disa dokumente dhe procesverbale e konstatime tjera nga Qendra për Punë Sociale.
36	Ardita Latifi, Udhëheqëse e Divizionit për Komunikim me Publikun-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë	Elektronik e	21.10.2025	22.10.2025	Anulohet	22.10.2025 Pala ka adresuar kërkesën e saj gabimisht në Institucionin tonë, andaj e njëjta është anuluar.

	01-034/01-0065395/25						
37	Edona Mehulli, Gazetare në Veriu.Info 01-034/01-0070770/25	Elektronik e	13.11.2025	14.11.2025	Refuzohet	02.12.2025	Pala ka kërkuar qasje në; Të gjitha shkresat e Lëndës të Drejtorisë Inspeksionit për mbindërtimin pa leje të "Medi Premium" 2) Të gjitha shkresat e Lëndës të Drejtorisë së Urbanizmit për mbindërtimin pa leje të "Medi Premium. Kërkesa në fjalë është trajtuar me afat shtesë prej 15 ditësh sipas Ligjit Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike.
38	Rrjeti i OJQ-ve "AVONET" 01-034/01-0073008/25	Elektronik e	27.11.2025	01.12.2025	Qasje e Plotë	02.12.2025	Pala ka kërkuar qasje në dokumentet që përfshijnë; 1. Ofertat e operatorëve ekonomik në aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material shtypës administrativ dhe mjekësor" me nr të prokurimit: 642-25-9179-1-1-1, 2. Të gjitha kërkesat e njësisë kërkuese për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material shtypës administrativ dhe mjekësor" me nr të prokurimit: 642-25-9179-1-1-1, 3. Deklarata e disponueshmerise financiare, për aktivitetin e prokurimit
40	Gazmend Morina	Elektronik e	01.12.2025	01.12.2025	Qasje e Plotë	18.12.2025	Pala ka kërkuar qasje në kërkoj qasje në: - Gjitha shkresat e lëndës të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Drejtorisë së Kadasit që kanë të bëjnë me lëshimin e lejes ndërtimore për këtë vendpunishje. Të bashkëngjitur gjeni pamje nga vendpunishja.

	Gazetar i gazetës “Veriu.info” 01-034/01-0073228/25					
41	Rimor Sahiti, Bannes në rrugën “Aftim Zhithia” 01-034/01-0074008/25	Fizike	03.12.2025	05.12.2025		Pala ka kërkuar qasje në dokumentin e Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës.
				Pasi që me këtë datë e ka pranuar zyrtarisht përgjigjet se për qasje në dokumente publike.		

42	Mejtem Veseli, Studente në drejtimin Gazetari 01-034/01-0075742/25	Elektronike	10.12.2025	11.12.2025	Qasje e Plotë	16.12.2025	Pala ka kërkuar qasje në dokumentet që tregojnë numrin e divorceve të regjistruara në Komunën e Mitrovicës gjatë viteve 2024-2025.
			Trajtimi i kësaj kërkesë ka filluar me datë 11.12.2025,				

			meqenëse kërkesa është dërguar pas orarit të punës.				
43	Sara Mulliqi, Studente në drejtimin Gazetari 01-034/01- 0075746/25	Elektronike	11.12.2025 Trajtimi i kësaj kërkesë ka filluar me datë 12.12.2025, meqenëse kërkesa është dërguar pas orarit të punës.	12.12.2025			Pala ka kërkuar qasje në dokumentet që tregojnë numrin total të rrugëve të rregulluara/asfaltuara në Komunën e Mitrovicës gjatë viteve 2024- 2025. Kërkesa në fjalë është trajtuar me afat shtesë prej 15 ditësh sipas Ligjit Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike.
44	Valentina Istrefi, Studente në drejtimin Gazetari 01-034/01- 0045738	Elektronike	10.12.2025 Trajtimi i kësaj kërkesë ka filluar me datë 11.12.2025, meqenëse kërkesa është dërguar pas orarit të punës.	11.12.2025	Qasje e Plotë	16.12.2025	Pala ka kërkuar qasje numrin total të fëmijëve të lindur dhe të regjistruar në Komunën e Mitrovicës gjatë viteve 2024-2025.

45	Liridonë Bislimi Musa 01-034/01- 0077903/25	Fizike	26.12.2025	26.12.2026				Pala ka kërkuar qasje në disa dokumente publike me qëllim të përpilimit të raportit: “Hapësirat e përbashkëta kreative në Kosovë” i cili synon të dokumentojë qasjen e komunave në hapësirat publike dhe menaxhimin e tyre.
46	Organizata “DYVO”- Development Youth Voices Organization 01-034/01- 0078166/25	Elektronike	29.12.2025	29.12.2025				Pala ka kërkuar qasje në disa dokumente publike me qëllim të përpilimit të raportit: “Hapësirat e përbashkëta kreative në Kosovë” i cili synon të dokumentojë qasjen e komunave në hapësirat publike dhe menaxhimin e tyre. Kërkesa në fjalë është në proces të trajtimit me afat shesë prej 15 ditësh sipas Ligjit Nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike.

Përfundim

Zyra për Komunikim me Publikun ka arritur rezultate të rëndësishme gjatë vitit 2025 në drejtim të rritjes së transparencës dhe besimit të qytetarëve në institucionet komunale.

Konsiderojmë edhe në vitin 2026, do të jemi në lartësinë e detyrave dhe përgjegjësiive të punës dhe angazhimeve tjera eventuale me interes të komunës, duke shpresuar që Zyra për Komunikim me Publikun të kompletohet me staf, si dhe të ngritën kapacitetet teknologjike.

Puna do të vazhdoj me përkushtim në vitin 2026 për të ndërtuar një komunikim gjithnjë e më të hapur, profesional dhe gjithëpërfshirës me publikun.